



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 372/4 prot.

Tiranë më 8.04.2019

VENDIM

Nr. 05, datë 8.04.2019

PËR KONTROLLUESIN "ERJOLA LEKA- (AMBER) PERSON FIZIK"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Erjola Leka – (Amber) person fizik",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 70 datë 28.02.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 20.03.2019 u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Erjola Leka – (Amber) person fizik", me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "Erjola Leka – (Amber) person fizik".

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "Erjola Leka – (Amber) person fizik", konstaton se:

1. Gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar, subjekti tregtar "Erjola Leka - (Amber) person fizik", mbledh të dhënat e klientëve të cilat konsistojnë në "emër" dhe "numër telefoni celular".

Në kuptim të nenit 3 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, subjekti "Erjola Leka - (Amber) person fizik" është kontrollues i cili mbledh dhe përpunon të dhëna personale "numër telefoni celular" dhe "emrat e qytetarëve" për subjektet e të dhënave "klientë", të cilët kontaktohen për qëllime marketingu mbi ofrimin e produkteve të reja.

2. Drejt numrave celularë 06820***** dhe 06844*****, janë kryer telefonata nga numrat +355675001300 dhe +355675009400, për ofrimin e produktit "Dyshek Amber". Referuar shkresës nr. 1452 prot., datë 21.02.2019 të Albtelekom dhe deklarimeve të përfaqësuesit të kontrolluesit, rezulton se këto numra janë në pronësi të subjektit "Erjola Leka - (Amber) person fizik". Kontrolluesi nuk ka administruar pëlqimin e subjekteve për t'i telefonuar në numrat personal, për qëllime marketingu mbi ofertat e produkteve.

Zyra e Komisionerit vlerëson se pëlqimi i subjekteve të të dhënave është e vetmja mundësi ligjore e kontrolluesit për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale, për arsye se nuk konstatohen kritere të tjera të ligjshme përpunimi nga ana e kontrolluesit. Në çdo rast, pëlqimi duhet të jepet me vullnetin e lirë dhe duhet të jetë i provueshëm (si në formë shkresore po ashtu edhe në formë elektronike), në zbatim të pikës 24 të nenit 3 të ligjit. Për sa kohë kontrolluesi nuk ka mundur të provojë ekzistencën e pëlqimit, Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave është i paligjshëm, duke cënuar edhe parimin e sanksionuar në germën "a" të pikës 1, të nenit 6 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

3. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së, protokollin e Zyrës së Komisionerit si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se kontrolluesi nuk ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

"Njoftimi" mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat kontrolluesi është përgjegjës, është një detyrim ligjor i rëndësishëm pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi kategorinë e të dhënave që përpunohen, qëllimin e përpunimit të tyre, realizimin e detyrimeve ligjore nga ana e kontrolluesit etj.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1 të nenit 21 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar: "Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.

4. "Erjola Leka - (Amber) person fizik" ushtron aktivitet marketingu nëpërmjet portalit www.amber.al i cili rezulton të jetë në posedim të subjektit tregtar "Donald Rama person fizik" me NUIS: L32327012B (referuar gjithashtu shkresës nr. 115/1 prot., datë 29.01.2019 të AKEP), përfaqësuar nga z. Donald Rama, i cili deklaroi në prezencë se është bashkëshort i znj. Erjola Leka. Kontrolluesi nuk ka vendosur "Politikat e Privatësisë" me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë portalin www.amber.al.

Informacioni i publikuar në "Politikat e Privatësisë", duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e

subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit, pika 1: *“Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale...”* dhe Vendimit nr.6/2013 *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”*.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin (datë 20.03.2019), të cilin përfaqësuesi i kontrolluesit e ka nënshkruar me komentin: *“Pretendimet do të përcillen me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve”*.

Më datë 27.03.2019 kontrolluesi ka paraqitur në rrugë elektronike pretendimet në lidhje me procesverbalin e hetimit administrativ, ku midis të tjerave shprehet se:

1. *“...Kontaktet që marrin në telefon për informacion mbi produktet që tregtojmë, hidhen në fletore dhe ri-kontaktohen brenda disa ditëve pasi kanë dhënë pelqimin verbal në telefonatën e mëparshme e cila behet nga vetë klienti drejtë kompanisë tonë. Këto të dhëna nuk ruhen dhe nuk rikontaktohen më. Në momentin që kthehen në blerës, japin pelqimin e tyre të firmosur në një formular të dorëzuar së bashku me faturën e blerjes. Në formular theksohet që të dhënat personale përdoren për të ruajtur dhe për t’ju përgjigjur klientit ndaj garancisë së produktit që ofrojmë. Kur klienti kërkon të ndërpresë marrdhënien me kompaninë tonë, absolutisht respektohet kërkesa e bërë prej tij dhe të dhënat fshihen.*
2. *Lidhur me numrat telefonik që kanë shprehur ankesë ndaj kompanisë “Amber”, deklarojmë që këto telefonata janë bërë gabimisht nga stafi dhe si këto raste mund të ketë raste të tjera, por janë gabime njerëzore, të cilat janë fenomene që ndodhin në të gjitha fushat e jetës. Mënyra operimit të kompanisë tonë është kontakti i drejtë për drejt me klientin “Dyqani” dhe jo shitje nëpërmjet telefonatave.*
3. *Nuk kam patur asnjë informacion në lidhje me detyrimin për të informuar Zyren e Komisionerit. Deklaroj që nga institucioni juaj nuk kam patur asnjë vizitë për të informuar në lidhje me procedurat që duhet të ndiqen për të qenë konform ligjit.*
4. *Nuk jam në dijeni të mënyrës së operimit në faqen e web-it dhe të facebook-ut mbi rregullat e privatësisë. Ritheksoj nuk jam vënë asnjëherë në dijeni nga ky institucion. Duke shtuar që faqja e webit dhe e facebook nuk përdoren për shitje apo nxitje të blerësve, është një mënyrë orientimi për t’i treguar klientit atë çka ofrojmë si kompani. Nëpërmjet faqes së facebook nuk është bërë asnjë kontakt për promocione.*
5. *Pas marrjes së informacionit nga ky kontroll, janë bërë ndryshimet përkatëse në faqen e web dhe facebook”*.

Në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, kontrolluesi *“Erjola Leka - (Amber) person fizik”* është

njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore në datën 02.04.2019 pranë ambjenteve të Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesi është paraqitur në seancë, ku ka argumentuar të njëjtat pretendime që ka paraqitur më parë në rrugë elektronike, si dhe ka dokumentuar rikuperimin e shkeljes administrative të nenit 18, duke vendosur politikat e privatësisë në portalin www.amber.al, por nuk ka vepruar në lidhje me rikuperimin e shkeljeve të tjera të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë tij.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ të cilat konsistojnë në mos kryerjen e "Njoftimit" pranë Zyrës së Komisionerit mbi përpunimin e të dhënave personale si dhe mungesën e pëlqimit të subjekteve për t'u telefonuar në numrat personal mbi ofertat e produkteve për qëllime marketingu, në kuptim të nenit 39, pika 1, gërmat "a" dhe "d" të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë:

- a) "Kontrolluesit që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me Kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10.000 deri në 500.000 lekë";
- d) Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Megjithatë, është marrë në konsideratë fakti që kontrolluesi është treguar bashkëpunues me grupin e kontrollit, ka reaguar pas konstatimit të shkeljeve si dhe ka përmbushur më vonë detyrimet për disa nga kërkesat ligjore. Kjo ka ndikuar ndjeshëm në zbutjen e masës së sanksionit

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 21, 29, 30, 39 pika 1 gërmat "a" dhe "d", si dhe nenet 40 dhe 41 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Erjola Leka - (Amber) person fizik", me gjobë në vlerën 40.000 (dyzetmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 6 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "Erjola Leka - (Amber) person fizik", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

3. Kontrolluesi "Erjola Leka - (Amber) person fizik", të marrë masa të menjëhershme për shkatërrimin e të dhënave të klientëve të përpunuara në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.
4. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
4. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 8.04.2019.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi



The image shows a handwritten signature in blue ink that reads "Besnik Dervishi". To the right of the signature is a circular official stamp in blue ink. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" at the top, "KOMISIONI QENDRORE DËNTORE PËR FIGHTEN E KORUPSIONIT DHE INFORMACIONIT" around the perimeter, and "TIRANË" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania. There is also a handwritten mark "Cet" inside the stamp.